



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Administrim Biznesi (+1)**

Fakulteti	Biznesi dhe Ekonomia
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	60

Përshkrimi i programit

Karriera

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

Aftësitë për të vlerësuar

Aftësitë e komunikimit

Aftësitë e të mësuarit

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [6.0 SETK] **Ekonomia e avancuar**
- [6.0 SETK] **Statistika aplikative**
- [6.0 SETK] **Sjellja organizative**
- [6.0 SETK] **Sistemi monetar dhe politika**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 2

- [6.0 SETK] **Standare ndërkombëtare të kontabilitetit**
- [6.0 SETK] **Ekonomia publike**
- [6.0 SETK] **Distribrimi dhe metodat e shitjes**
- [6.0 SETK] **Etika afariste dhe përgjegjësia shoqërore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Ekonomia e avancuar**

Kjo lëndë përbëhet prej dy pjesëve: mikroekonomisë dhe makroekonomisë. Në kuadër të mikroekonomisë studiohet sjellja e konsumatorit brenda ekzistimit të buxhetit të kufizuar dhe funksionimit të tij të plotë – maksimalizimi i shfrytëzueshmëria, sjellja e ndërmarrjes në strukturat e ndryshme tregtare dhe roli dhe funksioni i tyre – maksimalizimi i profitit. Në mikroekonomi studiohen edhe faktorët dhe çmimet e tyre dhe roli i shtetit në rregullimin e bizneseve dhe të segmenteve të pasuksesshme të tregut. Makroekonomia e studion funksionimin e ekonomisë në tërësi. Në këtë kontekst vëmendja është fokusuar në madhësitë më të rëndësishme makroekonomike: prodhimin bruto të vendit, inflacionin, papunësinë, kursimin, investimet, kursin devizor etj.. Vëmendje e posaçme u kushtohet faktorëve të cilët e prishin baraspeshën makroekonomike në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë dhe natyrën e karakterin e politikave të rëndësishme makroekonomike, nëpër të cilat tentohet që prodhimi bruto faktik i vendit të afrohet aq sa është e mundur me lëvizjen e prodhimit bruto potencial të vendit.

- **Statistika aplikative**

Përmes kësaj lënde studentët do t'i kuptojnë dhe do t'i zbatojnë elementet e statistikës deskriptive, teorinë e gjasës të ndjekur me gjasën dhe shpërndarjen e kopjeve, llogaritjen e parametrave shpërndarëse, llogaritjen dhe kontrollimin e hipotezave statistike, testimin e hipotezave, analizën e variantit, analizat lineare dhe analizat e serive kohore, regresionin dhe korrelacionin e thjeshtë linear.

- **Sjellja organizative**

Lënda synon t'i njoftojë studentët me sjelljen organizative dhe me psikologjinë organizative. Nga kjo pikë vështrimi studentët duhet të fitojnë njohuri përkatëse nga lëmi i liderizmit, fuqisë, autoritetit, punës ekipore, konfliktit, rolit dhe rëndësisë së organizimit të biznesit individual, etj.

- **Sistemi monetar dhe politika**

- **Standare ndërkombëtare të kontabilitetit**

Lënda përfshin: standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, kapitalin, mjetet dhe rezervat e vazhdueshme, mjetet financiare, detyrimet, letrat me vlerë, kërkesat e blerësve, përkufizimet aktive kohore, detyrimet ndaj furnizuesve, rezervat afatshkurtra dhe afatgjata, përkufizimet pasive kohore, shpenzimet materiale dhe jomateriale, shpenzimet e rrogave dhe amortizimin, caktimin e detyrimeve të TVSH-së dhe tatimit të fitimit, caktimin e rezultatit financiar.

- **Ekonomia publike**

Intenca kryesore e lëndës është t'u ndihmojë studentëve në kuptimin e dallimeve midis sektorit publik dhe privat. Në këto suaza, gjithashtu, duhet të sqarohet logjika, organizimi dhe mënyra e funksionimit të sektorit publik në botë dhe në Republikën e Maqedonisë.

- **Distribuidimi dhe metodat e shitjes**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njohë studentët me konceptin e shitjes dhe distribuimit, dallimet midis këtyre dy veprimtarive, si dhe metodat moderne të përdorura në ekonominë e tregut në procesin e shitjes dhe efikasitetin e shpërndarjes, kanalet e shpërndarjes, kriteret dhe strategjitë e shpërndarjes.

- **Etika afariste dhe përgjegjësia shoqërore**

Lëndë zgjedhore

- **Komunikimi afarist**

Qëllimi i lëndës është që t'i njoftojë studentët me konceptin e komunikimit afarist. Kohëve të fundit kompanitë gjithnjë e më shumë i aplikojnë teknikat e komunikimit afarist si mjet kryesor për t'iu përgjigjur konkurrencës në tregun global. Kjo lëndë është një përpyetje për të përmirësuar aftësitë e komunikimit të studentëve si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik në një mjedis organizativ me punonjësit dhe menaxherët, gjatë mbledhjeve, intervistave; si të përgjigjen gjatë intervistimit, negocimit dhe motivimit të rrethit.

- **Menaxhmenti ndërkombëtar**

Objektivat e lëndës janë: * Analiza e problemeve themelore të ekonomisë ndërkombëtare; * Diskutimi i marrëdhënieve midis biznesit vendas dhe atij ndërkombëtar; * Vlerësimi i faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në menaxhmentin ndërkombëtar; * Kompletimi i një analize SWOT të kompanive të ndryshme ndërkombëtare dhe

përcaktimi i tregjeve të reja globale;

- **Menaxhimi i portfolios**

Lënda “Menaxhimi i portfolios” trajton nocionet dhe funksionet themelore të sistemit financiar, ndërmjetësit tregtar, instrumentet tregtare, parimet dhe organizimin e punës dhe rolin e tyre në ekonominë e përgjithshme dhe në sistemin financiar, posaçërisht të ekonomive kombëtare. Tregjet dhe instrumentet financiare në fjalë janë të kohës më të re. Këto funksionojnë në ekonomitë e zhvilluara të perëndimit. Paraqitja dhe zhvillimi i tyre e nxisin zhvillimin e sektorit rajonal, shfrytëzimin optimal dhe alokimin e resurseve të pakta, ndikojnë ndaj madhësive dhe vlerave makroekonomike.